

**STATUT  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"FRESH DISTRIBUTION SH.P.K"**

**HYRJE**

Sot ne daten 29.03.2024 sipas Aktit te Themelimit ortaket themelues hartojne statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "Fresh Distribution SH.P.K". Shoqeria gezon statusin e personit juridik shqiptar dhe si e tille ne respektim te Neneve 24-38 te Kodit Civil dhe Ligjt Nr. I31/2015, " Per Qendren Kombetare te Biznesit" fiton personalitet juridik e per pasoje do te filloje aktivitetin e saj pas regjistrimit ne Regjistrin Tregtare te Qendres Kombetare te Biznesit si dhe ne organet tatile, ne zbatim te neneve 20/1, 26, 28, 32, 35, te po ketij ligji, si dhe gjithashtu mbeshtetje te Nenit 230 te Ligjt Nr.9901 date 14/04/2008, "Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare". Aktiviteti i shoqerise do te zhvillohet duke u mbeshtetur ne dispozitat e ketij Statusi.

**KREU 1  
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA**

**NENI 1  
DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT**

Sot, me 29.03.2024 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "Fresh Distribution SH.P.K".

Emertimi i shoqerise ndiqet nga akronimi "SHPK", sipas keresave te Ligjt Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".

Ndryshimi i emrit te shoqerise mund te behet vetem me Vendim te Asamblese se Pegjithshme.

**Themeluesit e shoqerise jane:**

**1.Z.Hysen Muja**, atesia Jemin, lindur ne date 16.03.1983, ne Berzhite, Tirane dhe banues ne adresen "Njesia Administrative Berzhite, ndertese private prane spitalit me Nr. 12-1037" me shtetesi shqiptare, madhor, me zotesi te plete per te vepruar, me mjet identifikimi numer 036546560 dhe numer personal I30316121N.

**2.Z.Emiljan Vogli**, atesia Ali lindur ne date 26.02.1986 ne Berzhite, Tirane dhe banues ne adresen "Njesia Administrative Berzhite, ndertese private prane spitalit me Nr. 27-1037" me shtetesi shqiptare, madhor, me zotesi te plete per te vepruar, me mjet identifikimi numer 035724942 dhe numer personal I60226048M.

**NENI 2 OBJEKTI**

**SHOQERIA DO TE KRYEJE AKTIVITETIN E MEPOSHTEM**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Fresh Distribution SH.P.K" dote zhvilloje aktivitet me objekt:

1. Tregetim me pakice dhe shumice ushqimesh, lengjesh, pijesh alkolike dhe jo alkolike etj.
2. Import-eksport, tregti te cdo lloj produkti dhe te mire duke respektuar ligjet ne fuqi.
3. Shoqeria mund te ushtraje gjithashu edhe aktivitete te tjera ndihmese ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te konsideruara me perfitim dhe te dobishme per arritjen e objektivave te saj kryesore.
4. Eksport-import e tregti me shumice e pakice te mallrave industrial, ushqimore, pajisje elektrike dhe elektro-shtepiake, hidraulike, ndertimore, tregtim te makinerive e pajisjeve dhe pjeseve te kembimit per pajisje dhe makineri. Tregtim mallrash per vete dhe te trete. Shitblerje automjetesh te ndryshme.

Shoqeria mund te kryeje te gjitha aktivitetet e dobishme dhe/ose te nevojshme te lejuara nga legjislacioni ne fuqi, per realizimin e objektit te veprintarise se shoqerise.

Objekti i veprimitarise te shoqerise mund te ndryshohet, perditesohet, plotesohet ne cdo moment me vendim te Asamblese se Ortakeve.

**NENI 3  
KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pa percaktuar duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB)

Shoqeria do te drejtohet nga Administratori Z. Ersi Rrumbullaku, me mjet identifikimi numer BB5428094 dhe numer personal K00412040S.

Shoqeria mund te prishet ose te pushoje aktivitetin e saj me nje vendim te Asamblese se Pergjitheshme te ortakeve, ne baze te legjislacionit Shqiptar dhe statutit te shoqerise

**NENI 4  
SELIA**

Shoqeria tregtare "Fresh Distribution SH.P.K" do te kete zyren qendrore ne adresen: "Njesia Administrative Berzhite, Fshati Berzhite, Rruga e Mujarakeve te Siperm, Nr.1- 1037- Tirane"

Per ndryshimin e selise, nese kjo do te konsiderohet e nevojshme, do te vendosin ortaket me vendim te Asamblese se zakonshme. Selia administrative do te jete ne po te njejten adresë.

Transferimi i selise brenda qytetit mund te vendoset nga organi administrativ dhe nuk do te sjelle modifikim te statutit. Me vendim te organit administrativ shoqeria mund te hape agjensi dhe zyra perfaqesimi ne rrethe te ndryshme, nderkohe qe edhe per krijimin e filialeve sekondare eshte i nevojshem vendimi i otakeve, veprim pas te cilit ajo mund te zhvilloje aktivitetin e saj brenda dhe jashte vendit.

**NENI 5  
VULA**

Shoqeria ka vulen perkatese, te cilat vendosen ne fund te cdo dokumenti.

**KREU II  
KAPITALI DHE KUOTATA, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT,  
KALIMI I KUOTAVE TE KAPITALIT**

**NENI 6  
KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10,000 Lekë (dhjete mijë) leke i ndarë me 2 (dy) kuota.

Pjesëmarja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- 1.Ortaku Z.Hysen Muja: Zoterues i nje kuote me vlore te per gjithshme 5,000 (pese mijë) leke qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise
- 2.Ortaku Z.Emiljan Vogli: Zoterues i nje kuote me vlore te per gjithshme 5,000 (pese mijë) leke qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise

**NENI 7  
ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet edhe nepermjet kontributeve në natyrë, nepermjet nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Shoqeria ne cdo kohe mund te zvogeloje kapitalin me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Ne cdo rast kapitali nuk mund te zvogelohet nen minimumin e vleres se kapitalit te kerkuar nga legjislacioni ne fuqi per shoqerite tregtare. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## **NENI 8** **TRANSFERIMI I KAPITALIT/MENYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TE KUOTAVE**

Shoqeria ka te drejte te transferoje kapitalin duke e vertetuar kete me akt notarial qe nenkupton se Ortaket themelues sipas % te zoterimit te pjeseve qe perbejne kapitalin e shoqerise gezojne te drejten qe pjeset e kapitalit themeltar ti transferojne tek te tretet.

Ortaket vodosin se secili prej tyre gezon respektivisht te drejten e parableres se kuotave te zoteruara ose pjeseve ne kuota ne rast se shitjes se tyre.

Ne rastin kur nga shoqeria largohet nje ortak dhe vendos ti shese kuotat e tij, ky kalim i kuotave kerkon respektimin e te drejtes se parableres ne favor te ortakut pjesemarres ne shoqeri apo ne favor te shoqerise sipas percaktimit te bere ne kete Statut.

Transferimi i pjeseve te kapitalit tek te tretet nenkupton shitjen dhe pjesetimin e kuotave, ky i fundit behet vetem me miratimin e shumices se ortakeve.

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kjo e fundit duhet te jete ne forme shkresore dhe ligjore.

## **KREU III** **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

### **NENI 9** **ORGANI VENDIMMARRES**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj.

Asambleja e perjithshme e ortakeve eshte perjegjese per mbajtjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e siperblimeve per personat e permendor ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike;
- f) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimitarise;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimitarise;
- h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- k) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- l) veshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e perjithshme, ne baze te nje autorizim i nga nje ortak tjeter apo

nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaquesues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se per gjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### NENI 10

#### MENYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PER GJITHSHME

Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese se per gjithshme.

Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes I te ketij nenit, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsis.

Mbledhja e Asamblese se per gjithshme mund te mbahet ne seline e shoqerise, ne video-konference ose ne nje vend tjeter te percaktuar me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

#### NENI 11 KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendur me fart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

#### NENI 12 MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e per gjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndajen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e per gjithshme vendos me shumicen e votave te orteve pjesemarres, per ceshtje te tjera si

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve
- e) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### NENI 13 PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shlyerjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo teper fitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin kontlikt interes, ashtusi dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

#### **NENI 14 ADMINISTRIMI**

Asambleja e per gjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratoret e shoqerise pa kufizim ne lidhje me shtetesine si administratoret e shoqerise.

Afati i emerimit, eshte 5 vite, me te drejte riperteritjeje. Ernerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Administratori mund te heqe dore ne cdo kohe nga detyra e tij neperrnjet, nje njoftimi me shkrim drejtuar Asamblese se per gjithshme te Ortakeve, te cilet duhet te caktojne nje administrator te ri.

Doreheqja e administratorit nuk cenon padite e shoqerise per shkelje te detyrimit te besnikerise qe adrninistratori ka ndaj saj, sipas legjislacionit te zbatueshem.

Te dhenat e identifikimit te administratorit:

- Ersi Rrumbullaku, shtetas Shqiptar, i lindur me 12.04.2000 ne Tirane dhe banuese ne Tirane, Shqiperi, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, me mjet identifikimi numer BB5428094 dhe numer personal K00412040S.

#### **NENI 15 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e per gjithshme;
- b) perfaqeson shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) percatit dhe nenshkuaran bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqet keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim;
- e) krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f) kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- g) raporton perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- h) kryen detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratori eshte i detyruar te therrase Asamblene e Pergjitheshme, ne raste kur:

- shoqeria nuk i mbulon detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5% te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane



vlere me te latte se 5% te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e per gjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## **NENI 16** **PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT**

Administratori eshte per gjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemandje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjesdis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me per gjegjesi ceshjet, per te cilat merret vendim;
- d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, per gjigjen ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe njedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo persona te lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta.

Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata per gjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e me poshtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet shoqerise;
- d) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikoje qe shoqeria nuk do te kishte paguese per te shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin finanziar, nese eshte e nevojshe. Asjne vendim i asamblese nuk mund te

ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

Administratori ka te drejte te lidhe marreveshje me persona te tjere fizike juridike vendas apo te huaj. Perfaqeson shoqerine ne te gjitha organizmat shteterore, gjiqesore dhe shoqerore publike apo private. Ai ka te drejte te beje mareveshje me te tretet sa i takon objektit te veprimtarise se shoqerise dhe brenda kompetencave te deleguara nga ortaku tjeter ose ortaket e tjere.

Po ne keto raste nuk mund te beje veprime qe lidhen me blerje apo investime qe e kalojne vleren e kapitalit themeltar te shoqerise, per te tilla do te jete i domosdoshem pelqimi me shkrim i ortakeve te tjere

Gjithashtu ka te drejte te marre te dhena dhe te beje propozime per gjithcka qe e cmon te dobishme per shoqerine. Te per gjigjet per demet qe mund ti vijne shoqerise nga veprimet e tij si dhe te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise.

Te pajtoje ekspertin kontabel te miratuar si edhe cdo person qe do te konsideroje te nevojsphem per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise. Gjithashtu ka te drejten te lidhe kontrata sipermanje dhe cdo forme tjeter sa i takon ushtrimit te veprimtarise se shoqerise tregtare dhe te respektoje detyrimet qe njedhin nga nenet 10, 12, 13, 14, 16, 17 18 te Ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Administratori mban per gjegjesi per te gjitha pasojat qe sjell veprimtaria e tij ndaj shoqerise si dhe te treteve. Ai per gjigjet individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqerise ose te treteve, per shkeljet ligjore te Statutit apo faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Shoqeria nuk mban per gjegjesi ndaj te treteve per aktivitete te kryera nga administratori ne kundershtim me kompetencat e tij, ne rast se provon se ata ishin dijeni te kesaj rrethane.

Administratori gezon te drejte te pakufizuar ne ushtrimin e tagreve te tij, me perjashtim te atyre qe ky Statut i ndalon ose mund ti ndalojne ne rast te ndryshimit te tyre sipas formes se kerkuar ligjore. Ne funksion te realizimit te detyrave te veta administratori mund te vere ne levizje instanca juridike dhe administrative, te mandatoje perfaqesues ligjore dhe te lesjoje prokura perfaqesimi, te kryeje operacione bankare, perfshire ketu hapje te llogarive rrjedhese.

Administratori mund te emeroje perfaqesues, duke i mandatuar per veprim ,individualisht ose kolektivisht,duke iu njobur te drejten dhe kompetencat qe ai do ti konsideroje te arsyeshme per tu kryer prej tyre ne funksion te realizimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, si dhe numd t'iu jape atyre shperblime dhe garanci sipas rastit qe ai do ta vleresoje kete gje si te arsyeshme. Sikurse mundet te emeroje drejtues apo perfaqesues per akte apo kategori te caktuar veprimesh.

## **KREUIV VITI FINANCIAR DHE BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMIVE, EKSPERTI**

### **NENI 17 VITI FINANCIAR**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 3 I Dhjetor.

### **NENI 18 EKSPERTET**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithvejetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte



ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tilie i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjenjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

**KREUV  
MARREDHENIET E PUNESIMIT**

**NENI 19  
PUNESIMI**

Shoqeria ka te drejte te punesoje persona fizike si specialiste ne arritjen e qellimit te fitimit duke zbatuar aktet ligjore mbi punesimin si dhe duke lidhur kontrata pune me secilin te punesuar.

**NENI 20  
PERGJEGJESIA**

Cdo person i punesuar ne shoqeri eshte personalisht perjegjes per plotesimin e detyrimeve qe mbart ne baze te kontrates se punes dhe ligjeve ne fuqi.

**NENI 21  
PASURIA E SHOQERISE**

Pasuria e shoqerise perbehet nga mjetet monetare te depozituara ne kohen e krijimit te saj por kjo mund te shtohet me pasuri te tjera ne para , ne matyre apo burime te tjera financiare.

**KREU VII  
PRISHJA - RIORGANIZIMI I SHOQERISE**

**NENI 22  
PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit Nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit";
- e) me vendim te gjykates;

Administratori regjistron prishjen e shoqerise prane QKB. Akti I themelimit dhe ky Statut si dhe te gjitha aktet e tjera te Shoqerise mund te konsiderohen te pavlefshem vetem ne rast se vijne ne kundershitim me dispozitat ligjore te ligjit 990 I date 14-04-08 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Kodin Civil. Ne raste te tilia shoqeria perqigjet per pasojet qe mund te kene pasur te tretet nga veprimtaria e saj.

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese" Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Likuidimi i shoqerise behet duke respektuar dispozitat 190-205 te ligjit 9901 date 14-04-2008 "Per Shoqerite

Tregare". Bazuar ne nenin 214-233 te po ketij ligji shoqeria mund te riorganizohet nepermjet bashkimit me nje shoqeri tjeter, nepermjet ndaljes ne dy apo me shume shoqeri te tjera ose nepermjet shnderrimit te formes ligjore. Sipas nenit 228/a nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar mund te shnderrohet ne shoqeri aksionare dhe anasjelltas. Po sipas ketij ligji Shoqerite tregtare qe nuk pershtaten me dispoziat e tij sipas nenit 230/2 te ketij ligji vleresohen te prishura dhe cregjistrohen nga QKB pas perfundimit te procedures se likujdimit.

### **NENI 23 RIORGANIZMI I SHOQERISE BASHKIMI-NDARJA**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vednimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, neperputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX teLigit 990 I date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

### **NENI 24 BAZA LIGJORE**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plate me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

### **NENI 25 MOSMARREVEŠHJET**


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per c;do mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

### **NENI 26 DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

Statuti i shoqerise "**Fresh Distribution SH.P.K**" perpilohet ne kater kopje origjinale secila dhe nenshkruhet ne cdo flete prej ortakeve themelues te saj.

### **ORTAKET E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "FRESH DISTRIBUTION SH.P.K"**

Z.Hysen MUJA



Z. Emiljan VOGLI

